

**PROJEKTRAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARIT**

MODEL

Tiranë më __/__/2020

NDARJA¹ A – TË DHËNAT E GJYQTARIT

Në këtë rubrikë plotësohen të dhënat personale të gjyqtarit, të dhënat për gjykatën ku ushtron funksionin, seksionin dhe periudhën e vlerësimit.

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Vjetërsia në detyrë:

Adresa e e-mailit zyrtar:

Adresa e e-mailit privat:

Numër telefoni:

Gjykata:

Funksioni:

Dhoma/Seksioni :

Vlerësimi i mëparshëm:

Masa disiplinore:

Periudha e vlerësimit :

NDARJA B – VLERËSUES

Relator :

Nëpunës përgjegjës për vlerësimin :

NDARJA C – QËLLIMI

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, i përgatitur nga relatori i caktuar me short, ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin

¹ Ndarjet dhe emërtimet e tyre me germa pasqyrohen në këtë projekt raport model për të orientuar pjesët e veçanta të aktit.

përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare.

Projekt raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, relatori bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit ashtu sikundër ato përshkruhen dhe detajohen në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

NDARJA D – PROCEDURA

Në këtë rubrikë përshkruhet, në rend kronologjik, procedura e ndjekur nga momenti i fillimit të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, deri në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit.

NDARJA E – ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.

Në këtë rubrikë analizohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet shkalla e aftësisë/nivelet të veprimtarisë së gjyqtarit për çdo tregues vlerësimi, bëhet pikëzimi dhe propozimi për nivelin e vlerësimit të gjyqtarit, për secilin nga katër kriteret e vlerësimit.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit, në lidhje me : përcaktimin e fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së saj; përcaktimin e ligjit të zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit, në lidhje me: interpretimin e ligjit,

arsyetimin për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi; zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes; kërkimin, identifikimin, organizimin dhe përdorimin e jurisprudencës vendase dhe ndërkombëtare; referimin dhe menaxhimin me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit, të praktikës së konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ dhe gjithë jurisprudencës në tërësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit, në lidhje me : përdorimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe; shprehjen e mendimit qartë dhe me sa më pak fjalë; zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; përzgjedhjen e kujdesshme të gjuhës dhe përdorimin e të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç); organizimin e paragrafëve dhe të strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; përdorimin në mënyrë korrekte dhe konsistente të termave teknikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit, në lidhje me hartimin e vendimit sipas një strukture të qartë, të qëndrueshme, të mirë organizuar gjatë prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura; ndjekjes së një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të vendimit, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit, në drejtim të cilësisë së analizës mbi bazën e një zhvillimit logjik të koncepteve ligjore, në lidhje me: identifikimin e marrëdhënieve shkak-pasojë; analizën e koncepteve, instituteve dhe dispozitave mes tyre ose zbatimin e tyre në një situatë të caktuar; analizën se si konceptet, institutet dhe dispozitat, lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar; përmbajtjen gjithëpërfshirëse duke iu dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve; nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

Propozim për nivelin e vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit në lidhje me respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive, duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afatin përkatës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit në drejtim të respektimit të afateve orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara.

Analiza e integruar të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë deri në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit në lidhje me kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje krahasuar me standardet minimale kohore për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi.

Analiza e integruar të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të

tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë deri në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit në lidhje me rendimentin e përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda një viti kalendarik.

Analiza e integruar të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohen aftësitë e gjyqtarit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore. Treguesi mesatar i kohës për arsyetimin e të gjitha vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh krahasohet me afatin procedural të parashikuar në ligj.

Analiza e integruar të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohet shkalla e aftësisë së gjyqtarit për përfundimin e gjykimit në një kohë sa më të shpejtë si dhe kryerja prej tij e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Relatori merr në konsideratë kompleksitetin dhe volumin e çështjeve si dhe kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore jo-produktive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues*).

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohet shkalla e aftësisë së gjyqtarit në drejtim të organizimit të procesit gjyqësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohet shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes gjyqësore në mënyrë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vlerësohet shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me përfshirjen në dosje të dokumentacionit të plotë, të saktë dhe që i përket çështjes konkrete ;

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, me qëllim vlerësimin e angazhimit

dhe përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit, sjelljen e kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Për këtë tregues, për shkak të parimit të prezumimit, në rast se nuk ka të dhëna për cenimin e integritetit të gjyqtarit, shkalla e integritetit prezumohet të jetë shumë e lartë. Në rast se nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna të mjaftueshme dhe të besueshme që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, shkalla e integritetit vlerësohet me 0 pikë.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e integritetit të gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në drejtim të shmangies së përdorimit të gjuhës diskriminuese, tendencës për paragjykitime dhe ndikimit të qëndrimeve personale në vendimmarrjen e gjyqtarit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Për të vlerësuar këtë tregues, pasi analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, relatori konkludon nëse numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, është tejet i lartë apo i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik në drejtim të komunikimit efektiv, të shprehurit në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe konçize me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Për këtë tregues, për shkak të parimit të prezumimit, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, të tilla që mund të çojnë në cënimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale, për të cilat gjyqtari vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e respektimit nga ana e gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik në drejtim të aftësisë dhe disponibilitetit të gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje, angazhimin në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njësuëse, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale..etj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.*)

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës apo në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, që synojnë ngritjen e tij profesionale.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin mbi bazën e shkallës së angazhimit që tregon gjyqtari në drejtim të ngritjes së tij profesionale nëpërmjet trajnimeve*)

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në drejtim të gatishmërisë së shfaqur nga gjyqtari për përfshirjen në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin mbi bazën e angazhimit të gjyqtarit në veprimtaritë e mësipërme*).

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në drejtim të gatishmërisë së gjyqtarit për pjesëmarrje në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi. (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin jo vetëm mbi bazën e angazhimit të gjyqtarit në veprimtaritë e mësipërme, por edhe të sasisë dhe cilësisë së kontributit të dhënë prej tij*).

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës të tilla si artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi (*Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin mbi bazën e shkallës së kontributit të dhënë nga gjyqtari për zhvillimin e doktrinës*).

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit

DARJA F- PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.

Propozim për nivelin e vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit		
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit		
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale		
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional		
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm		

NDARJA G – PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, bën propozim për trajnime dhe/ose rekomandon hapa të cilët i vlerëson të nevojshëm për t’u ndërmarrë nga gjyqtari me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së tij.

RELATOR

(EMRI, MBIEMRI DHE NËNSHKRIMI)

SHTOJCA 1

Shtojca 1 përbëhet nga një format tabelar që përmban kriteret e vlerësimit, treguesit, nivelin e vlerësimit, pikëzimin për çdo tregues dhe kriter dhe nivelin e vlerësimit dhe pikëzimin total të gjyqtarit.